

KËRKIME GJUHËSORE

Rozeta BICI

SFIDAT E PËRKTHIMIT NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE NË FUSHËN JURIDIKE

Abstrakt. Përkthimi është një nga detyrat më të vështira për një studiues apo një njohës të gjuhëve të huaja. Ky është rezultat i faktit që procesi i përkthimit jo vetëm kërkon një njohje të mirë të gjuhës, përshtatje të strukturave të dy gjuhëve të përdorura, njohje të terminologjisë në përputhje me fushën e studimit, por edhe një përzgjedhje të metodës së përkthimit. Fusha juridike, duke qenë se është e pasur me terminologji, ashtu siç është dhe specifike në bazë të legjislacionit të shtetit përkatës, është një ndër fushat më të vështira. Sfidat ku duhet të kalojë një përkthyes gjatë një përkthimi me profil juridik është dhe synimi i këtij artikulli dhe objekti i studimit.

Artikulli përmes një analize dhe përjasjeje të dokumenteve e çështjeve juridike në të dyja aspektet e gjuhës do të nxjerrë në pah vështirësitë e kapërcimit të këtyre sfidave, gjithashtu si dhe përmes përdorimit të metodave të ndryshme bashkëkohore. Një ndër dokumentet juridike është dhe kushtetuta e Shqipërisë, duke qenë themeli dhe legjislacioni më i rëndësishëm i një shteti. Artikulli do t'u vijë në ndihmë atyre studiuesve që lidhen me këtë fushë.

Fjalët kyçe: përkthim, metoda përkthimi, kushtetuta, sfidat, gjuhë shqipe, gjuhë angleze, profil juridik, ligj.

Përkthimi është një nga detyrat më të vështira për një studiues ose për një njohës të gjuhëve të huaja. Ky është rezultat i faktit se procesi i përkthimit nuk kërkon vetëm njohuri të mira të gjuhës, por gjithashtu edhe, një përshtatshmëri të strukturave të të dyja gjuhëve në fjalë, njohuri të terminologjisë së lidhur me fushën e studimit, dhe seleksionimin e metodës së përkthimit, dhe për më tepër efektin e kulturës së dy gjuhëve në fjalë. Fusha juridike, duke marrë në konsideratë se është e pasur me terminologji, për më tepër, është specifike në bazë të legjislacionit të një vendi të caktuar, është një nga fushat më të vështira. Sfidat, që përkthyesi duhet të kalojë gjatë një përkthimi me profil juridik, është qëllimi i këtij artikulli si dhe objekti i studimit të tij.

Përpara se të analizoj faktorët që influencojnë përkthimin, është me relevancë akademike të përkufizohen termat kryesore. Në këtë mënyrë, fillojmë me përkufizimin e fjalës përkthim. Sipas fjalorit të gjuhës Angleze "Oxford", ai është "procesi i përkthimit të fjalëve ose teksteve nga një gjuhë në një tjetër"¹. Përveç atij përkufizimi, i cili tingëllon shumë i thjeshtë, fusha e përkthimit ndikon në të gjithë procesin dhe e bën punën e një përkthyesi / interpretuesi një të ngjashme me një dhimbje duke marrë në konsideratë që ai / ajo duhet të përballet me sfida të ndryshme. Gjatë përkthimit të një kopjeje në Brenda fushës juridike, përkthyesi duhet të mbajë në mendje këtë që vijon. "Metoda ligjore e tekstit në gjuhën origjinale është përgatitur në një mënyrë që të përshtatet me etnicitetin dhe

¹ <http://oxforddictionaries.com/definition/translation?q=translation>

kjo replikohet në gjuhën ligjore; në të njëjtën mënyrë, teksti i përkthyer duhet të lexohet nga dikush i cili është në dijeni më një sistem tjetër ligjor dhe gjuhën e tij.”² Si rrjedhojë, meqë fokusi i këtij artikulli është të analizojë përkthimet ligjore, ku Kushtetuta e Shqipërisë në dy versionet e saj në gjuhën shqipe dhe angleze do të shërbejë si një dokument ilustrues, unë do të nxjerr në pah sfidat e hasura nga dhe të përqs këto dy versione. Pjesa tjetër e artikullit ka për qëllim analizën e metodave të përkthimit të cilat përshtaten më mirë dhe disa këshilla për të lehtësuar përkthimin ligjor.

Duke marrë në konsideratë qëllimin e përkthimit, kuptohet se “në përgjithësi, qëllimi i përkthimit është të riprodhojë tipe të ndryshme tekstesh – duke përfshirë tekstet fetare, letrare, shkencore dhe filozofike – në një gjuhë tjetër dhe kështu i bën ato të mundësueshme për lexues më të gjerë.”³ Përkthimi ligjor është i veçantë për vështirësitë e tij duke qenë se duhet të kalojë në disa faza. Shumë studiues e lidhin përkthimin me disa procedura të cilat janë të nevojshme të ndiqen. Këto procedura ndahen në dy kategori, procedura teknike dhe organizuese. Procedurat teknike lidhen me analizën e gjuhëve të origjinalit dhe përkthimit⁴. Kështu që përfshin një studim të komponentëve të gjuhës në origjinal si dhe analizën e disa fushave gjuhësore si semantika. Për sa i përket procedurave organizuese, ato kanë të bëjnë me përpjekjet e përkthyesit për të zgjidhur problemet e përkthimit. Orduari citon në veprën e tij Seguinot (1989) i cili beson se ekzistojnë të paktën tri strategji globale që përdoren nga përkthyesit: 1. Të përkthyerit pa ndërprerje sa më gjatë të mundeni; 2. të korrigjuarit e menjëhershëm të gabimeve sipërfaqësore; 3. të lënit monitorimin për gabimet stilistikore dhe cilësore në një tekst për fazën e përsëritjes. Direkt merret me organizimin e veprës, duke nisur më parë me të lexuarit dhe përkthimin e të gjithë veprës dhe procesimin e saj.

Personalisht, unë jam dakord me Riquier, i cili pretendon se kur punohet me përkthimin, një përkthyes si fillim duhet të deshifrojë tekstin dhe pastaj ta rikonstruktojë kuptimin e tij në tekstin në gjuhën e përkthyer. Kjo është, mendoj unë, faza e parë e procedurës së organizimit të një përkthimi ligjor. Më pas një përkthyes duhet të nisë të marrë në konsideratë aspektin terminologjik dhe strukturor të gjuhëve të origjinalit dhe të përkthimit. Sigurisht në këtë fazë ai/ajo has problemet e para të cilat lidhen me lakunat apo boshllëqet leksikore. Gjithashtu, varësia kulturore e tekstit ligjor është vështirësia tjetër me të cilën një përkthyes duhet të përballet. Ndonjëherë strukturat gjuhësore të gjuhës së origjinalit nuk janë të njëjta me ato të gjuhës së përkthimit. Gjuha shqipe dhe angleze janë një burim i mirë krahasimi duke marrë parasysh se gjuha shqipe nuk

² Armando. Riquier, “Techniques of Legal Translations” in <http://www.articlesbase.com/languages-articles/techniques-of-legal-translations-236926.html>

³ Mahmoud. Ordudari, “Translation procedures, strategies and methods” in <http://www.bokorlang.com/journal/41culture.htm>

⁴ Ibid.

SFIDAT E PËRKTHIMIT NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE NË FUSHËN JURIDIKE

ka një rend të ngulitur të fjalëve në fjali; krejt e kundërta ndodh me gjuhën angleze. Si pasojë vetëm duke krahasuar një nen nga Kushtetuta e Shqipërisë në gjuhën shqipe dhe angleze mund të kuptohet ky ndryshim në strukturat e fjalive: Neni 29 pika 2: “Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.” përkthehet “No punishment may be given that is more severe than that which was contemplated by law at the time of commission of the criminal act.” Ne mund të arrijmë në konkluzion se ka një kryefjalë në fillim të versionit të përkthyer, e kundërta nga gjuha shqipe. Pastaj ndiqet nga një folje, kurse në versionin shqip ka një inversion. Kjo tregon se përkthyesi duhet të përshtatë përkthimin me strukturën e gjuhës së përkthimit, përveç përkthimit të tekstit.

Por cilat janë disa nga metodat apo teknikat e përkthimit të përdorura gjatë përkthimit ligjor si dhe karakteristikat e tyre?

Gjatë një analize të metodave dhe teknikave të përkthimit janë evidente edhe përpjekjet e përkthyesit. Ekzaktësisht disa nga metodat e përdorura në përkthim janë: përkthimi fjalë për fjalë, përkthimi letrar, përkthim i besueshëm, përkthim semantik, përshtatje, përkthim i lirë, përkthim idiomatik dhe përkthim komunikues.

Përkthimi fjalë për fjalë, i njohur në anglisht si *Word for Word Translation* ka të bëjë me rastin kur rendi i fjalëve në gjuhën e origjinalit ruhet dhe fjalët përkthehen veçmas nga shumica e kuptimeve të tyre të përgjithshme jashtë nga konteksti⁵. Për shembull:

“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit, vendosim këtë Kushtetutë.” përkthehet: “We, the people of Albania, proud and aware of our history, with responsibility for the future, and with faith in God and/or other universal values, with determination to build a social and democratic state based on the rule of law, and to guarantee the fundamental human rights and freedoms, with a spirit of tolerance and religious coexistence, with the pledge for the protection of human dignity and personhood, as well as for the prosperity of the whole nation, for peace, well-being, culture and social solidarity, with the centuries-old aspiration of the Albanian people for national identity and unity, with a deep conviction that justice, peace, harmony

⁵ Mahmoud. Ordudari, “Translation procedures, strategies and methods” in <http://www.bokorlang.com/journal/41culture.htm>

and cooperation among nations are among the highest values of humanity, we decide this constitution”

Në këtë rast, në përkthimin e preambulës, vërejmë se ka një përpjekje të madhe për të ruajtur rendin e fjalëve dhe strukturat e fjalive.

Përkthimi letrar ose siç i referohemi në gjuhën angleze *Literal Translation* ka të bëjë me konstruktet gramatikore të gjuhës së origjinalit, dhe mënyrën se si ato kthehen në ekuivalentet më të afërta në gjuhën e përkthimit, por sërish leksemat sërish përkthehen veçmas, jashtë nga konteksti⁶.

Kur implementohet përkthimi i besueshëm ose siç njihet në gjuhën angleze *Faithful Translation*, përkthyesi përpiqet të prodhojë kuptimin kontekstual preciz të origjinalit brenda limiteve të strukturave gramatikore të gjuhës së përkthimit⁷.

Përkthimi Semantik, referuar në anglisht si *Semantic Translation* ndryshon nga përkthimi i besueshëm vetëm për sa i përket rëndësisë që i jep vlerës estetike të tekstit në gjuhën origjinale⁸.

Përshtatja e njohur në gjuhën angleze si *Adaptation*, e cila është forma më e lirshme e përkthimit, dhe kryesisht përdoret për drama (komedi) dhe poezi; temat, personazhet, fabula zakonisht ruhen, kultura e gjuhës së origjinalit konvertohet në kulturën e gjuhës së përkthimit dhe teksti rishkruhet⁹.

Përkthimi i Lirë, ose siç i referohemi në gjuhën angleze *Free Translation* prodhon tekstin në gjuhën e përkthimit pa stil, formë, ose përmbajtje nga origjinali¹⁰.

Përkthimi Idiomatik (*Idiomatic Translation*) piprodhon ‘mesazhin’ e origjinalit por ka tendencë të shtrembërojë nuancat e kuptimit duke preferuar kolokualizmat dhe idiomat kur këto nuk ekzistojnë në gjuhën e origjinalit¹¹.

Përkthimi Komunikues (*Communicative Translation*) përpiqet që të sjellë kuptimin kontekstual ekzakt të origjinalit në një mënyrë të tillë që të dyja përmbajtja dhe gjuha të jenë thuajse të pranueshme dhe të kuptueshme për lexuesin¹².

Siç ilustruhet më lart, ekzistojnë tipe të ndryshme metodash përkthimi, por zgjedhja e tyre, është një sfidë tjetër për përkthyesin, duke marrë në konsideratë se përkthyesi duhet të zgjedhë midis tyre, cila përshtatet më mirë qëllimit dhe tipit të dokumentit. Ndonjëherë edhe kombinimi i tyre implementohet, duke konsideruar faktin se unë personalisht, mendoj se secila prej tyre ka limitet e veta. Prandaj, duke i analizuar ato një e nga një, mund të nxirren në pah limitet veçanërisht kur natyrat e gjuhëve të origjinalit dhe të përkthimit janë

⁶ Ibid.

⁷ Ibid.

⁸ Ibid.

⁹ Ibid.

¹⁰ Ibid.

¹¹ Mahmoud. Ordudari, “Translation procedures, strategies and methods” in <http://www.bokorlang.com/journal/41culture.htm>

¹² Ibid.

SFIDAT E PËRKTHIMIT NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE NË FUSHËN JURIDIKE

kaq të ndryshme si rasti i gjuhës shqipe dhe angleze. Kështu që përkthimi fjalë për fjalë është i vështirë të implementohet duke marrë parasysh se gjuha shqipe nuk ka një rend të caktuar fjalësh, kurse gjuha angleze ka. Si e tillë, është e vështirë të ruhen strukturat e gjuhës shqipe gjatë përkthimit. Limiti i përkthimit letrar lidhet me faktin se ai i përkthen fjalët veçmas dhe jashtë kontekstit, por konteksti është vërtetë i rëndësishëm në procesin e përkthimit, pasi teksti është në koherencë dhe bazohet në të gjithë kontekstin. Përkthimi semantik lidhet me nuancat estetike të tekstit, por në rastin e përkthimeve ligjore nuk ka lidhje të aspektit estetik. Përshtatja e cila nga përkufizimi duket se është më tepër për tekstet letrare, mund të përshtatet për përkthimet ligjore gjithashtu. Në të kundërt, përkthimi i lirë, i cili duket se i jep liri përkthyesit, krijon problemin që përkthimet ligjore nuk duhet të interpretohen apo të përmbledhen a komentohen, përkthyesi nuk duhet ta përdorë lirinë e dhënë në këtë rast. As përkthimi idiomatik nuk shërben në rastin e përkthimeve ligjore, sepse shtrembëron kuptimin. Përkthimi komunikues është më i pranueshëm dhe më i përshtatshëm për përkthimin ligjor pasi përmbajtja dhe gjuha janë më të pranueshme për lexuesin. Vihet re se secili nga tipet e përkthimeve ka limitimet e veta dhe një metodë e caktuar nuk është totalisht e vlefshme të implementohet nga fillimi e deri në përfundim të përkthimit të materialit. Si pasojë, një kombinim i të gjitha metodave të përkthimit i jep më shumë mundësi përkthyesit të bëjë një punë të mirë në fushën ligjore.

Siç e përmenda në fillim të artikullit, fusha ligjore gjithashtu lidhet me aspektin kulturor të shoqërisë të cilës i përket. Si e tillë, gjatë përkthimit të një dokumenti ligjor, përkthyesit i duhet të përkthejë konceptet specifike kulturore. Pavarësisht se i përkasin vendit të gjuhës së origjinalit, ato duhet të përkthehen dhe të sillen sa më të gjalla të jetë e mundur edhe në gjuhën e përkthyer. Për këtë arsye, përveç zgjedhjes së metodave dhe teknikave të përkthimit, përkthyesit përballen me sfidën tjetër, atë të përkthimit të koncepteve dhe termave specifikë-kulturorë. Kjo ka qenë një çështje me rëndësi për shumë studiues si: Graedler, Harvey dhe Newmark, të cilët e kanë trajtuar atë në punimet e tyre dhe ato kanë dalë në konkluzione me disa procedura të përkthimit të koncepteve specifike-kulturorë.

Si rrjedhojë, Graedler specifikon procedurat si vijojnë: të krijosh një fjalë të re; të shpjegosh kuptimin e shprehjes në gjuhën e origjinalit në vend të përkthimit të saj; të ruash të paprekur termin në gjuhën e origjinalit; të kërkosht një fjalë në gjuhën e përkthimit e cila të duket e njëjtë ose të ketë të njëjtën “relevancë” si termi në gjuhën e origjinalit; dhe të përcaktosh termat e lidhur me kulturën¹³. Kështu që, është evidente se qartësimi dhe përkufizimi shërbejnë më shumë sesa përkthimi i termave që lidhen apo shprehin konceptet specifiko-kulturore. Një përkthyes nuk mund të përkthejë një kulturë por vetëm ta shpjegojë atë, në mënyrë që lexuesi i gjuhës së përkthimit ta kuptojë atë në mënyrë korrekte. Kjo është arsyeja që Graedler thekson faktin se përkthyesi ose duhet të shpikë një

¹³ Ibid.

fjalë ose të gjejë një fjalë ekuivalente në gjuhën e përkthimit, duke marrë në konsideratë se çdo fjalë në një gjuhë mund të bartë një nuancë tjetër në një gjuhë tjetër. Një shembull i kësaj të fundit mund të jetë përkthimi i nenit 78:

“Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. - The Assembly decides with a majority of votes, in the presence of more than half of its members, except for the cases where the Constitution provides for a qualified majority.”

Në këtë rast fjala asamble është vendosur si relevante për gjuhën e përkthimit dhe shpjegimi është dhënë duke u bazuar mbi kushtetutën.

Për më tepër, Harvey sjell disa procedura të tjera, si: ekuivalenca funksionale; të gjeturit e ekuivalencës formale dhe gjuhësore; përdorimi i transkriptimeve dhe huazimeve; dhe përdorimi i përkthimit përshkrues dhe vetë-shpjegues.

“Ekuivalenca Funksionale (Functional Equivalence): Nënkupton përdorimin e një referuesi në kulturën e gjuhës së përkthimit funksioni i të cilit është i ngjashëm me atë të referuesit në gjuhën e origjinalit. Harvey shkruan, autorët ndahen për sa i përket meritave për këtë teknikë: Weston e përshkruan atë si “metoda ideale e përkthimit” kurse Sarcevic e vlerëson atë si “keqduhëzuese dhe se duhet të shmanget.” **Ekuivalenca Formale ose ‘ekuivalenca gjuhësore’ (Formal Equivalence or ‘linguistic equivalence’):** Nënkupton një përkthim ‘fjalë për fjalë’.

Transkriptimi ose ‘huazimet’ (Transcription or ‘borrowing’) (p.sh. të riprodhosh ose aty ku është e nevojshme, të transliterosh termin origjinal): kjo qëndron në qëllimin e largët të strategjive të orientuara nga gjuha e origjinalit. Nëse termi është formalisht transparent ose shpjegohet në kontekst, ai mund të përdoret vetëm. Në raste të tjera, veçanërisht kur mendohet se lexuesi nuk ka asnjë njohuri për gjuhën e origjinalit, transkriptimi shoqërohet nga shpjegimi ose një shënim shpjegues.

Përkthim përshkrues ose vetë-shpjegues (Descriptive or self-explanatory translation): Përdor termat gjenerike jo ato të lidhura me kulturën për të shprehur kuptimin. Është i përshtatshëm në një gamë të gjerë kontekstesh ku ekuivalenca formale konsiderohet si pamjaftueshmërisht e qartë. Në një tekst i cili i drejtohet një lexuesi të specializuar, mund të vijë në ndihmë nëse shtojmë termin origjinal të gjuhës së origjinalit për të shmangur ambiguitetin.”¹⁴

Përkthimi i nenit 95 demonstroi këto parime me të cilat përkthimi bëhet sipas ekuivalencës formale ku vihet re përkthimi fjalë për fjalë: “Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat. - The Council of Ministers consists of the Prime Minister, deputy prime minister, and ministers.”

Sërisht nga më lart, ne mund të vëmë re qartësisht se konceptet e specifiko-kulturore nuk janë objekt përkthimi por se ato sillen ashtu siç ekzistojnë

¹⁴ Mahmoud. Ordudari, “Translation procedures, strategies and methods” in <http://www.bokorlang.com/journal/41culture.htm>

SFIDAT E PËRKTHIMIT NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE NË FUSHËN JURIDIKE

në gjuhën e origjinalit, disa nga herët madje dhe huazohen ashtu siç janë: p.sh. ratifikim, ekstradim, etj. Në shumicën e rasteve disa fjalë edhe transkriptohen ashtu siç janë në gjuhën e origjinalit dhe kuptimet e tyre shpjegohen në kllapa.

Kurse, Newmark vazhdon në më shumë detaje dhe propozon procedura të ndryshme përkthimi. Procedurat sipas tij janë si vijojnë:

Transferimi (Transference); Natyralizimi (Naturalization); Ekuivalenti kulturor (Cultural equivalent); Ekuivalenti funksional (Functional equivalent); Ekuivalenti përshkrues (Descriptive equivalent); Analiza përbërëse (Componential analysis); Sinonimia (Synonymy); Përkthim i ndërmjetëm (Through-translation); Spostimet ose transpozimet (Shifts or transpositions); Modulimi (Modulation); Përkthim i njohur (Recognized translation); Kompensimi (Compensation); Perifrazimi (Paraphrase); Çiftet (Couplets); dhe Shënimet (Notes).

“Transferimi i njohur në anglisht me termin **Transference**: është procesi i transferimit të tekstit nga gjuha e origjinalit në atë të përkthimit. Përfshin transliterimin dhe është i njëjtë me atë që Harvey e quan “transkriptim”.

Natyralizimi ose në anglisht (**Naturalization**): është adaptimi i fjalës së parë të gjuhës së origjinalit më shqiptimin normal, pastaj në morfologjinë normale të gjuhës së përkthimit.

Ekuivalenti Kulturor (Cultural equivalent): nënkupton të zëvendësosh një fjalë kulturore të gjuhës së origjinalit me një tjetër të gjuhës së përkthimit. Gjithsesi, “ato nuk janë të sakta”.

Ekuivalenti Funksional (Functional equivalent): kërkon përdorimin e një fjale kulturore neutrale.

Ekuivalenti përshkrues (Descriptive equivalent): në këtë procedurë kuptimi i termit të bazuar në kulturë shpjegohet me disa fjalë.

Analiza përbërëse (Componential analysis): nënkupton “të krahasuarit e një fjale të gjuhës së origjinalit me një fjalë të gjuhës së përkthimit e cila ka një kuptim të ngjashëm por nuk është dukshëm një ekuivalent i barasvlershëm, duke demonstruar së pari komponentët e tyre të përbashkëta dhe të ndryshme.”

Sinonimia (Synonymy): është një “ekuivalent i afërt në gjuhën e përkthimit” Këtu ekonomizimi i fjalëve triumfon mbi ekzaktësinë.

Përkthimi i ndërmjetëm (Through-translation): është përkthimi letrar i kolokualizmave të përdorshme, emrave të organizatave dhe komponentëve të fjalëve të përbëra. Gjithashtu mund të quhet: përkthim kalk ose huazim.

Spostimet dhe Transpozimet (Shifts or transpositions): përfshin një ndryshim në gramatikë nga gjuha e origjinalit në atë të përkthimit për shembull, (i) ndryshim nga numri njëjës në numrin shumës, (ii) ndryshimi kërkohet kur një strukturë e gjuhës së origjinalit nuk ekziston në gjuhën e përkthimit, (iii) ndryshim i një foljeje të gjuhës së origjinalit në një fjalë të gjuhës së përkthimit, ndryshim i një grupi emëror nga gjuha e origjinalit në një emër në gjuhën e përkthimit, etj.

Modulimi (Modulation): ndodh kur përkthyesi riprodhon mesazhin e tekstit origjinal në tekstin në gjuhën e përkthimit në komformitet me normat

aktuale të gjuhës së përkthimit, pasi gjuha e origjinalit dhe ajo e përkthimit mund të duken jot ë ngjashme në termat e perspektivave.

Përkthimi i njohur (Recognized translation): ndodh kur përkthyesi “zakonisht përdor përkthimin zyrtar ose të pranuar në përgjithësi nga çdo kusht institucional.”

Kompensimi (Compensation): ndodh kur humbja e kuptimit të një pjese të fjalisë kompensohet në një pjesë tjetër.

Parafrazimi (Paraphrase): në këtë procedurë shpjegohet kuptimi i termave të bazuar në kulturë. Këtu shpjegimi është më i detajuar sesa ai tek ekuivalenti i përshkrimit.

Çiftet (Couplets): ndodh kur përkthyesi kombinon dy procedura të ndryshme.

Shënimet (Notes): shënimet janë informacion shtesë në një përkthim. Shënimet mund të shfaqen në formën e ‘footnotes’. Edhe pse disa studiues stilistike e konsiderojnë përkthimin e mbushur me footnotes të tmerrshëm për sa i përket pamjes, gjithsesi, përdorimi i tyre mund të ndihmojë lexuesit e gjuhës së përkthimit të gjykojnë më mirë mbi përmbajtjen e tekstit original. Nida mbron përdorimin e footnotes për të përmbushur të paktën funksionet e mëposhtme: (i) për të sjellë informacion suplementar, dhe (ii) për të tërhequr vëmendjen tek problemet e origjinalit.”¹⁵

Si një shembull i rasteve të mësipërme mund të përdoret përkthimi i nenit 61 ku thuhet: “Avokati i Popullit mund të jetë çdo shtetas shqiptar, me arsim të lartë, me njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit. - Any Albanian citizen with higher education, and with recognized knowledge and recognized activity in the field of human rights and law may be the People’s Advocate.” Në këtë rast, ne kuptojmë përshtatjen sipas rendit të caktuar të fjalëve në gjuhën angleze si dhe gjithashtu sinoniminë e fjalës së njohur në vend të një sinonimi të njohur ose një tjetër sinonimi.

Përveç atyre që u përmendën më lart, konteksti kulturor specifik shfaqet se ka nevoja të veçanta gjatë përkthimit. Si rrjedhojë, disa forma specifike të përkthimit ndodhin gjatë përkthimit veçanërisht kur bëhet fjalë për fushën ligjore ku legjislacioni i një vendi tregon totalisht kulturën e tij, një kulturë e cila nuk mund të transferohet totalisht në një kulturë tjetër, për shkak të faktit se ajo nuk mund të kuptohet ashtu siç ekziston nga një grup njerëzish të gjuhës së përkthimit.

Përveç metodave dhe teknikave të përkthimit të këshilluara nga studiues të ndryshëm, disa përkthyes ligjorë kanë arritur në konkluzione dhe kanë nxjerrë rregulla përkthimi dhe disa këshilla gjithashtu. Kështu që disa këshilla që janë të nevojshme të ndiqen nga përkthyesit janë: ai/ajo duhet të jetë një gjuhëtar/e ose një person me arsim ligjor në mënyrë që të përmbledhë pikat kryesore në një tekst. Për më tej, përkthyesi duhet të studiojë metodat se sit ë shpjegojë mendimet ligjore në gjuhën vendase në një dokument i cili është i ndryshëm në gjuhën e përkthimit apo sistemin ligjor të një vendi tjetër. Veçmas kësaj, përkthyesi duhet

¹⁵ Ibid.

SFIDAT E PËRKTHIMIT NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE NË FUSHËN JURIDIKE

të jetë i aftë të dekodojë tekstin e origjinal dhe ta rikonstrukttojë atë në gjuhën e përkthimit. Në shumë situata problem që ato hasin janë: zgjedhja e fjalëve ose frazave, struktura e fjalive dhe origjinaliteti¹⁶. Këshilla tjetër për t'u ndjekur është: të modifikojë çdo fjalë për t'u siguruar që të ketë rrjedhshmëri dhe kuptim për lexuesin në gjuhën e përkthimit. Është e rëndësishme të mos përdoren fjalë të cila nuk kuptohen nga lexuesit. Konsultimi i një fjalori juridik është i rëndësishëm gjithashtu. Parafrazimi nuk lejohet në përkthimet ligjore dhe gjuha duhet të jetë formale. Përkthyesi nuk duhet të shtojë asnjë koment port ë jetë preciz. Duhet të jetë një përkthim letrar sa më shumë të jetë e mundur. Nëse përkthyesi mendon se diçka nuk shkon, ai/ajo nuk duhet ta ndryshojë atë por të bëjë një shënim në lidhje me atë çështje.¹⁷

Si konkluzion, "Përkthimi ligjor është shpesh më i vështiri nga tipet e tjera të përkthimeve teknike për shkak të lidhjes së sistemit të natyrës së terminologjisë ligjore." Ndryshe nga terminologjia shkencore ose teknike, çdo shtet ka terminologjinë e vet ligjore (bazuar mbi sistemin ligjor të atij shteti), i cili shpesh do të jetë thuajse i ndryshëm edhe për sa i përket terminologjisë ligjore të përdorur në një shtet tjetër me të njëjtën gjuhë."¹⁸ Gjithashtu, duhet të përfordhet roli i metodave dhe teknikave të përkthimit ndërsa merremi me një tekst specifik, veçanërisht lidhur me fushën ligjore, pasi përfshin në vetvete jo vetëm të diturit e leksikut por gjithashtu dhe përzgjedhjen e metodës ose teknikës së duhur. Për më tepër, aspekti kulturor i gjuhës së origjinalit është një faktor i rëndësishëm i cili i shton punës së përkthyesit një ngarkesë tjetër, duke marrë në konsideratë se të përkthyerit e një teksti është i manaxhueshëm por të përkthesh kulturën e një vendi, është shumë e vështirë, pasi duhet të sillet e kuptueshme në kulturën e lexuesit të gjuhës së përkthimit. Kjo e bën përkthyesin të bëhet një lloj shkrimtari i tekstit të origjinalit për faktin se ai/ajo nuk do të përballet me ngarkesën e krijimit të një fjale të re ose të përshtatë nuancat e disa nga fjalëve ekzistuese. Kështu që një metodë ose teknikë specifike nuk është e mjaftueshme për të përkthyer një dokument, por një miksim i tyre mund të shërbejë për ta sjellë atë të gjallë e sa më afër origjinalit. Klienti gjithashtu, është faktori tjetër, veçanërisht kur puna porositet nga dikush. Klienti gjithashtu bëhet pronari i tekstit në origjinal dhe kërkon plotësimin e nevojave të tij.

¹⁶ Jamie. Hanson, "Methods to Translate Legal Documents" in <http://www.articlesnatch.com/Article/Methods-To-Translate-Legal-Documents-/1788716#ixzz1vLg4KerH>

¹⁷ Braniac, "How to Translate Legal Documents" in http://www.ehow.com/how_2134889_translate-legal-documents.html#ixzz1vLhxBlVP

¹⁸ Steven Kahaner "Issues of Legal Translation" in ccaps newsletter in www.ccaps.net

BIBLIOGRAFI

- Braniac, "How to Translate Legal Documents" in
http://www.ehow.com/how_2134889_translate-legal-documents.html#ixzz1vLhxBlVP
- Griffin, Xeres. "How to translate Legal Documents" in
<http://www.howtodothings.com/careers/how-to-translate-legal-documents>
- Hanson, Jamie. "Methods to Translate Legal Documents" in
<http://www.articlesnatch.com/Article/Methods-To-Translate-Legal-Documents-/1788716#ixzz1vLg4KerH>
- Kahaner, Steven. "Issues of Legal Translation" in ccaps newsletter in
www.ccaps.net
- Ordudari, Mahmoud. "Translation procedures, strategies and methods" in
<http://www.bokorlang.com/journal/41culture.htm>
- Riquier, Armando. "Techniques of Legal Translations" in
<http://www.articlesbase.com/languages-articles/techniques-of-legal-translations-236926.html>
- The Albanian Constitution of 1998, Albanian Version
The Albanian Constitution of 1998, English Version
<http://oxforddictionaries.com/definition/translation?q=translation>